



Prishtinë, 24 qershor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_632_1_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16, Nenit 18, Nenit 22 dhe Nenit 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e nenit 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr.03/L-048);
- Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës (nr. 04/L-233);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe Nenit 6 të Rregullës për Taksat; dhe
- Propozimin për lirim të të licencuarve nga pagesa e taksës vjetore të datës 17.06.2014,

në seancën e mbajtur me datë 24 qershor 2014, nxori këtë:

V E N D I M

- I. LIROHEN** nga pagesa e taksës vjetore të licencuarit për prodhimin dhe importin e energjisë elektrike, për periudhën nga data 01 prill 2014 deri 31 tetor 2014.
- II. LIROHEN** nga pagesa e taksës vjetore të licencuarit, për prodhimin e energjisë termike për periudhën nga data 01 tetor 2014 deri 31 mars 2015.
- III. OBLIGOHEN** të licencuarit e energjisë termike që ta paguajnë borxhin nga periudhat paraprake, në të kundërtën lirimi nga dispozitivi nën II., për lirim nga pagesa e taksës vjetore nuk vlen.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji mbledh taksa të inkasuara nga ndërmarrjet e licencuara dhe aktivitetet tjera, të cilat taksa janë të hyra të dedikuara për ZRRE-në. Taksat vjetore dhe taksat tjera janë të përcaktuara sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për Taksat.
- Taksat vjetore mblidhen në mënyrë që të mundësohet vetë qëndrueshmëria financiare e ZRRE-së për veprim me kosto efektive.
- Për shkak të specifikave të sektorit të energjisë termike, të cilat operojnë vetë gjatë sezonit dimëror, nga periudha tetor i vitit paraprak - prill të vitit vijues, dhe rrjedhimisht faturohen për

taksën vjetore të licencuarit vetëm për këta muaj, të licencuarit për prodhimin e energjisë termike lirohen nga pagesa e taksës vjetore të licencimit për periudhën tetor 2014-prill 2015.

- Zyra e Rregullatorit për Energji pas arritjes së vetë- qëndrueshmërisë financiare dhe me qëllim të harmonizimit të Të Hyrave me buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014, liron të licencuarit nga pagesa e taksës vjetore të licencimit, si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që:
 - Të Hyrat e gjertanishme të mbledhura sipas Nenit 7 dhe 8 të Rregullës për Taksat plotësojnë Buxhetin e aprovuar të ZRRE-së për vitin 2014 sipas Ligjit të Buxhetit.
 - Lirimi nga pagesa e kësaj takse për këtë periudhë, për ndërmarrjet që prodhojnë energji elektrike dhe termike do të reflektohet në përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për periudhën e ardhshme të shqyrtimit të tarifave (viti 2015), përmes bashkërendimit të të Hyrave të Lejuara.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit. ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar

Vendimi u dërgohet:

Të Licencuarve;
Stafit të financave dhe
Akivit të ZRRE-së